

Forumi i Politikave të Integritimit monitoron nga afër procesin e integritimit në Bashkimin Evropian dhe institucionet e përfshira në të, duke u përqendruar kryesisht në koordinimin ndërinstytucional ndërmjet njërive dhe dokumenteve dhe raporteve të tyre ligjore. Treguesit e monitorimit dhe rregullat metodologjike përfshijnë aktet normative dhe/ose legjislative të miratuara; aktivitetet e kryera (numri i takimeve, plan-veprimeve, raportet, strategjitë për të adresuar mangësitë e identifikuara nga raporti i KE, etj.); fazën e zhvillimit paraprakisht të instrumenteve; si dhe shqyrtimin institucional dhe publik të rezultateve të arritura.

# **ROLI I PARLAMENTIT NË PROCESIN E INTEGRIMIT NË BE: NË KËRKIMIT TË NJË KATALIZATORI TË MIRËFILLTË**

**Gentiola Madhi**  
**EU Policy Hub**

## **PANORAMA E PËRGJITHSHME**

Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian është një prioritet kombëtar ndërpartiak i deklaruar, i mbështetur nga një pjesë e konsiderueshme e shoqërisë civile vendase. Vet përparimi i vendit në procesin e anëtarësimit në BE është kryesisht përgjegjësi e qeverisë, ndonëse me kalimin e kohës edhe parlamenti ka arritur një vlerësim të caktuar për kontributin e tij drejt arritjes së gjithëpërfshirjes në përmbushjen e këtij qëllimi kombëtar. Në përgjithësi, përfshirja e parlamentit konsiderohet si një hap pozitiv në mënyrë të dyfishtë, përkatësisht nëpërmjet ushtrimit të vazhdueshëm të funksioneve të tij mbikëqyrëse mbi performancën e qeverisë, si dhe përmes mundësisë për të siguruar një përfshirje të gjerë të opozitës dhe palëve të tjera të interesit në këtë proces kombëtar kyç, duke pasur parasysh funksionin e tij përfaqësues.

Katër vjet më parë, Parlamenti shqiptar miratoi [ligjin nr. 15/2015](#), me qëllim forcimin e mëtejshëm të rolit dhe kontributit të tij në procesin e integritimit në BE. Dispozitat e këtij ligji parashikojnë gjithashtu një rregullim më të mirë të

marrëdhënieve midis parlamentit dhe qeverisë, si dhe me institucionet e BE-së në përgjithësi gjatë procesit të anëtarësimit. Ligji gjithashtu përfshin dispozita specifike për krijimin e një mekanizmi të ri bashkëpunimi dedikuar tërësisht procesit të integritimit, përkatësisht Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian (KKIE).

KKIE u krijua në maj 2015 si organi më i lartë këshillimor kombëtar pranë Parlamentit për çështjet e integritimit në BE, i cili synon të ofrojë orientim strategjik dhe të përmirësojë konsensusin e gjerë kombëtar. Ky është një mekanizëm konsultativ që sjell së bashku përfaqësuesit e partive politike, institucionet publike, organizata të shoqërisë civile, komunitetin e biznesit dhe median. Qëllimi i tij i përgjithshëm është garantimi i një bashkëpunimi gjithëpërfshirës, transparenca dhe mundësimi i konsensusit për çështje të integritimit në BE.

Gjithashtu, ligji 15/2015 përsërit se në ushtrimin e funksioneve të tij në kuadër të procesit të integritimit të vendit, Parlamenti duhet të marrë pjesë dhe të kontribuojë në mënyrë proaktive në forumet e bashkëpunimit ndër-parlamentar rajonal dhe evropian. Në këtë drejtim, i bëhet një

referencë e qartë Komitetit Parlamentar për Stabilizim-Asociimin BE-Shqipëri (KPSA), i cili është krijuar tashmë në vitin 2010 në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. KPSA synon të përmirësojë bashkëpunimin ndërparlamentar dhe ndërpartiak, si dhe të forcojë dialogun politik për një axhendë të plotë dhe të qëndrueshme të reformave në BE në vendet e zgjerimit. KPSA është një organ konsultativ që sjellë së bashku përfaqësuesit e Parlamentit të Shqipërisë dhe Parlamentit Evropian.

Në vite, performanca e këtyre dy mekanizmave të bashkëpunimit parlamentar ka pësuar luhatje si rezultat i ndikimit të ushtruar nga agjendat e vet partive politike. Prandaj, deri në njëfarë mase, këto mekanizma kanë vuajtur drejtpërdrejt pasojat e klimës së polarizuar dhe mungesës së vazhdueshme të dialogut midis partive politike shqiptare.

Përballë kësaj situate, ky punim monitorues synon të vlerësojë se deri në çmasë secili prej këtyre mekanizmave bashkëpunues - KKIE dhe KPSA - kanë arritur të realizojnë potencialin e tyre dhe të kontribuojnë në promovimin e procesit të integritit të Shqipërisë. Fokusi i kësaj analize do të jenë aktivitetet e kryera nga KKIE dhe KPSA gjatë viteve 2017-2018. Ky është një vlerësim i dytë (*follow up*) performancës së punës së KKIE-së dhe KPSA-së, të botuara respektivisht në [2016](#) dhe [2017](#).

Ky punim është bazuar në një qasje analitike në dy nivele, duke synuar të hedh dritë në të njëjtën kohë mbi dimensionin e brendshëm dhe të jashtëm të bashkëpunimit parlamentar në Shqipëri. Duke patur parasysh mosmarrëveshjet e vazhdueshme politike midis partive në vend, ky punim synon të analizojë dinamikat e brendshme të KKIE-së, si dhe pasqyrimin e ndasisë së brendshme midis përfaqësuesve të delegacionit parlamentar

shqiptar gjatë takimeve të KPSA-së me kolegët nga Parlamenti Evropian. Ky hap konsiderohet thelbësor për një kuptim më të gjerë të nivelit efektiv të kontributit të Parlamentit në progresin e Shqipërisë drejt integritit në BE.

Nga pikëpamja metodologjike, kjo analizë bazohet në një shqyrtim të detajuar të kornizës ligjore dhe dokumenteve zyrtare, të fjalimeve publike, artikujve dhe procesverbaleve të mbledhjeve të mekanizmave nën shqyrtim. Punimi ka një natyrë kryesisht cilësore dhe instrumenti sasior është përfshirë aty ku është e mundur, në mënyrë që të ofrojë informacion shtesë për qëllimin e kësaj analize.

Si përfundim, punimi synon të identifikojë pengesat kryesore që ndikojnë në arritjen e një kontributi të kënaqshëm të Parlamentit në procesin e integritit në BE, si dhe në rritjen e ndërgjegjësimit midis segmenteve të ndryshme të shoqërisë mbi nevojën për të proceduar me miratimin e masave pajtuese shtesë në këtë fazë të procesit. Pjesa e parë e punimit ofron një pasqyrë të dialogut politik në nivel kombëtar gjatë periudhës kohore në shqyrtim, pasuar nga një vlerësim i përgjithshëm i efektivitetit të bashkëpunimit në nivelin e KKIE-së dhe KPSA-së, duke theksuar sfidat kyçe dhe potencialet e pashfrytëzuara. Së fundmi, është dhënë një listë rekomandimesh për të adresuar pengesat e identifikuar.


### **“DIMRI I ASHPËR” I DIALOGUT POLITIK**

Në dekadat e fundit, puna e Parlamentit shqiptar është karakterizuar nga një mungesë e dialogut politik dhe pozicione kontradiktore të thella midis koalicionit/partisë qeverisëse dhe opozitës. Bojkotet e zgjatura të partive opozitare kanë penguar në shfrytëzimin e kapacitetit të përgjithshëm të Parlamentit për të

monitoruar siç duhet zbatimin e legjislacionit të miratuar, si dhe performancën e ekzekutivit.

Në këtë mënyrë, gjatë dy viteve të fundit, Parlamenti është përballur me sfidën e vazhdueshme të një klime politike tepër konfrontuese, e cila ka penguar drejtpërsëdrejti përpjekjet e tij në fushën e integritimit evropian. Veçanërisht, viti 2017

**Figura 1:** Kalendari i bojkotit të opozitës, 2017 - 2018



*Burimi:* Përpunim i autorit.

Pas një zbutje fillestare të marrëdhënieve midis partive politike në fillim të legjislaturës së nëntë të Parlamentit shqiptar, semestri i dytë i vitit 2018 u karakterizua sërish nga një bojkot de facto i aktiviteteve nga koalicioni opozitar i qendrës së djathtë. Efektet e bllokadës së vazhdueshme politike dhe paralizimi i veprimtarisë parlamentare mbi performancën e KKIE-së dhe KPSA-së do të analizohen më vete në seksionet vijuese.

Për shkak të kësaj situatë komplekse, mekanizmat mbikëqyrës në dispozicion nuk kanë kontribuar mjaftueshëm në ushtrimin e kënaqshëm të funksioneve të Parlamentit. Në veçanti, "[puna e komisioneve të hetimit \[ka\] mbetur tepër konfliktuale dhe kanë munguar rezultatet](#)". Për të luftuar këtë polarizim, [Parlamenti Evropian](#) i ka bërë thirrje të shpeshta aktorëve të shoqërisë në Shqipëri që të marrin pjesë aktivisht në proceset e konsultimit publik dhe të kontribuojnë në forcimin e demokracisë lokale,

është karakterizuar nga një krizë e thellë politike, ku opozita e krahut të djathtë ka bojkotuar aktivitetet parlamentare. Siç vërehet në figurën 1, paraliza e Parlamentit të shkuar ka zgjatur de facto për gati nëntë muaj dhe është kërkuar një ndërmjetësim ndërkombëtar për të rikthyer praninë e opozitës në rrugën e dialogut.

transparencës dhe llogaridhënies. Megjithatë, në praktikë, mundësia e një hapësire të tillë për pjesëmarrjen e aktorëve jo-politik duket se është tkurrur dhe është e vështirë të rimarrë veten në një klimë politike të polarizuar.

Në përgjithësi, dialogu dhe bashkëpunimi ndërpartiak në Parlament kanë ndjekur një tendencë përkeqësimi, duke penguar përpjekjet për të përmbushur kriteret politike dhe për të zbatuar në kohë reformat kyçe. Në mungesë të një pune konstruktive të opozitës brenda institucioneve demokratike, ka mbetur në dispozicion një perspektivë e kufizuar për të çuar përpara axhendën e anëtarësimit në BE dhe për të përmbushur afatin e parashikuar për hapjen e negociatave në 19 qershor 2019.

### **KËSHILLI KOMBËTAR I INTEGRIMIT EVROPIAN**

Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian është një forum konsultativ, që synon të kontribuojë në arritjen e një dialogu

konstruktiv dhe të qëndrueshëm midis spektrit politik dhe aktorëve kyç të shoqërisë në Shqipëri, në mënyrë që të përmirësojë, nxisë dhe avancojë axhendën e reformave për në BE. Ky mekanizëm është i mandatuar për të nxitur pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse dhe ndërtimin e konsensusit kombëtar, së bashku me sigurimin e rekomandimeve të përshtatura për çështjet e integritimit.

KKIE operon në bazë të [rregullores](#), e cila u miratua me vendimin nr. 67 të Byrosë së Parlamentit, më 4 maj 2016. Këto dispozita rregullojnë funksionimin e përgjithshëm të KKIE-së, duke siguruar kështu instrumentet e nevojshme për të shfrytëzuar potencialin e tij dhe duke lehtësuar krijimin e një dialogu konstruktiv dhe të qëndrueshëm në nivel ndërpartiak.

**Kutia 1:** *Kompetencat dhe përgjegjësitë kryesore të KKIE-së*

- Promovimi i bashkëpunimit midis partive politike dhe aktorëve të tjerë të interesit;
- Nxitja e debatit mbi politikat e integritimit në BE dhe monitorimi i progresit të negociatave për anëtarësim;
- Vlerësim i kuadrit normative ekzistues dhe praktikave që lidhen me procesin e integritimit evropian;
- Shkëmbim informacioni me institucionet më të larta mbi çështjet e BE-së;
- Këshillim, dhënie opinioneve dhe miratim rekomandimesh mbi procesin e negociatave.

Sipas kësaj rregullore, KKIE duhet të organizojë takimet e tij të paktën një herë në dy muaj, në prani të më shumë se gjysmës së anëtarëve të tij të përhershëm. Megjithatë, në praktikë kjo dispozitë nuk është respektuar për shkak të marrëdhënieve konfrontuese midis partive politike dhe bojkotit të shpeshtë të aktiviteteve parlamentare nga opozita. Performanca e KKIE-së gjatë 2017-2018

është prekur në një farë mase nga betejat e vazhdueshme politike, duke krijuar kështu një varësi të drejtpërdrejtë midis funksionimit të zakonshëm të KKIE-së dhe pranisë së opozitës në aktivitetet parlamentare. Në një farë mase, kjo varësi krijohet nga fakti se takimet e KKIE-së thirren në mënyrë procedurale nga Kryetari, i cili vjen nga opozita (përkatesisht nga Partia Demokratike).

Duke u fokusuar tek **aktivitetet** e KKIE-së gjatë periudhës nën shqyrtim, siç vërehet edhe në tabelën 1, janë mbajtur vetëm tre takime, nga të cilët një takim në fillim të shkurtit 2017 dhe dy në vitin 2018. *Agjenda* e takimeve është përqendruar kryesisht në seanca dëgjimore me ministrin/zëvendësministrin përgjegjës për portofolin e integritimit evropian, mbi zbatimin e pesë prioritetëve kryesorë dhe hapat përpara për krijimin e strukturës kombëtare së negociatave.

Këto takime janë karakterizuar nga një luhajtje në *pjesëmarrje* e anëtarëve të përhershëm, veçanërisht duke ju referuar përfaqësuesve të opozitës. Takimi i fundit i KKIE-së u organizua në mungesë të plotë të përfaqësuesve të opozitës (me përjashtim të një deputeti nga Lëvizja Socialiste për Integritim), për shkak të bojkotit të vazhdueshëm. Në bazë të nenit 7 të rregullores, ky takim u thirr përmes një kërkesë me shkrim të firmosur nga 1/3 e anëtarëve të përhershëm të KKIE-së dhe u kryesua nga Zëvendëskryetari (nga Partia Socialiste). Kjo përbën një zgjidhje alternative për të thyer varësinë e funksionimit të KKIE-së nga agenda bojkotuese e opozitës. Sidoqoftë, ende mbetet për t'u vlerësuar se deri në çfarë mase ky zhvillim do të arrijë të çojë përpara përmbyshjen e saktë të misionit të KKIE-së dhe efikasitetin në lidhje me procesin e anëtarësimit.

**Tabela 1:** Takimet e KKIE-së, 2017-2018

Nr. takimeve	Data e lajmërimit	Data e takimit	Agjenda	Kryetari
I	2.02.2017	9.02.2017	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dëgjesë e Zv/Ministrit të Integritimit Evropian mbi zbatimin e pesë prioriteteve kyçe</li> <li>Diskutim mbi Shkollën Verore Evropiane 2016 dhe forcimin e kapaciteteve të administratës publike</li> </ul>	Majlinda Bregu (PD)
II	6.03.2018	26.03.2018	<ul style="list-style-type: none"> <li>Prezantim i strategjisë së zgjerimit nga Kryetarja e Delegacionit të BE-së në Shqipëri</li> <li>Dëgjesë e Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme mbi hapat që do ndërmerren drejt hapjes së negociatave për anëtarësim</li> <li>Diskutim mbi Shkollën Verore Evropiane 2018 dhe rinovimi i mandateve të OSHC-ve dhe medias</li> </ul>	Genc Pollo (PD)
III	26.11.2018	10.12.2018	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dëgjesë e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme mbi progresin e procesit të integritimit dhe përgatitjet për ngritjen e strukturës kombëtare të negociatave</li> </ul>	Genc Pollo (PD)

*Burimi:* Faqja e internetit e Parlamentit; përpunim i autorit.

Analiza e procesverbaleve tregon se *cilësia e debateve* gjatë këtyre takimeve është karakterizuar nga një përsëritje e retorikës politike, akuza të ndërsjellta të vazhdueshme dhe përsëritje e debateve që zhvillohen gjatë seancave të zakonshme të komisioneve parlamentare. Ky shqetësim është ngritur nga përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile dhe komuniteti i biznesit gjatë takimeve të KKIE-së, duke theksuar kështu nevojën për të investuar më shumë në një *menaxhim korrekt të kohës* dhe për të mundësuar hapësirë të mjaftueshme për kontribute nga aktorët jo-politikë. Ndonëse z. Pollo në [fjalimin e tij të parë si kryetar i KKIE-së](#) theksoi angazhimin e tij për të intensifikuar monitorimin e zbatimit të reformave të integritimit në BE dhe organizimin e diskutimeve të vazhdueshme me shoqërinë civile për këto çështje, fatkeqësisht kjo nuk u materializua në praktikë.

Në përgjithësi, gjatë periudhës në shqyrtim, ka pasur pak mundësi për të investuar seriozisht në nisjen e një dialogu

tematik ndërpartiak brenda KKIE-së dhe për të gjetur një kompromis për miratimin e një deklaratë/konkluzioni të përbashkët - të një natyre jo detyruese - në fundi i secilit takim. Që nga themelimi i tij, KKIE ka arritur të miratojë vetëm një vendim, me konsensus (më 26 mars 2018), për publikimin e thirrjes për aplikime për rinovimin e mandateve të përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Lidhur me **kontributin e shoqërisë civile dhe të komunitetit të biznesit** në Këshillin Kombëtar për Integritimin Evropian, pak hapësirë është vënë në dispozicion për përfshirjen dhe reagimet (*feedback*) e tyre gjatë takimeve. Këta të fundit kanë kërkuar në mënyrë të përsëritur mbajtjen e takimeve më të shpeshta dhe teknike të KKIE-së, si dhe miratimin e një rezolute të përbashkët për hapjen e negociatave të anëtarësimit (8 mars 2018). Megjithatë, nuk janë ndërmarrë veprime pasuese (*follow-up*). Deri më tani, KKIE nuk ka arritur të ketë

rolin e pritshëm të një forumi të gjerë konsultativ mbi çështjet e BE-së.

Megjithatë, përfshirja e shoqërisë civile në punën e KKIE-së mbetet ende e qartësuar dhe duhet të zhvillohet dhe të miratohen instrumentet e duhura për përfshirjen e tyre konkrete. Dispozitat në fuqi theksojnë se KKIE duhet të ketë tre përfaqësues me të drejtë vote nga radhët e organizatave të shoqërisë civile, me një mandat të vlefshëm prej dy vjetësh (të rinovueshëm). Në vitin 2015 janë pranuar të gjashta OSHC-të që kanë aplikuar për pjesëmarrje në KKIE dhe nuk është proceduar me modifikimin e bazës ligjore. Megjithatë, me kalimin e kohës numri i OSHC-ve u rrit në tetë, pa një shpjegim/evidencë publike të qartë në raportin vjetor.

Aktualisht, *mandati i përfaqësuesve të OSHC-ve* ka skaduar që nga maji i vitit 2017, ndonëse ata ende marrin pjesë në ato pak takime të KKIE-së. Në përputhje me [vendimin e marrë në mbledhjen e datës 26 mars 2018](#), sekretariati teknik vazhdoi me publikimin e thirrjes për aplikime për përfaqësuesit e OSHC-ve në prill 2018 dhe mbërritën 12 shprehje interesi. Megjithatë, deri më tani ripërtëritja e mandateve të OSHC-ve nuk është përfshirë në agjendën e takimeve të KKIE-së dhe çështja është ende pezull.

Ndërkaq, përsa i përket *përfaqësuesve të medias*, thirrja për aplikime për rinovimin e mandateve është publikuar dy herë gjatë vitit 2018 dhe nuk ka mbërritur asnjë shprehje interesi. Komuniteti i medias ka treguar pak interes për punën e KKIE-së dhe kjo ishte po ashtu e dukshme në vitin 2015 kur u ndeshën të njëjtat vështirësi me qëllim që dy përfaqësues të medias të ndiqnin takimet.

Së fundi, duke u përqendruar tek **aktivitetet** e KKIE-së, organizimi i Shkollës Verore Evropiane përbën arritjen e vërtetë të këtij mekanizmi konsultativ

kombëtar. Edicionet vjetore të shkollës janë ndjekur nga profesionistë me background dhe përvoja pune të ndryshme. Për momentin nuk është bërë ende publik një vlerësim impakti/follow-up mbi zbatimin e njohurive të fituara nga këta përfitues.

Përsa i përket programit vjetor të aktiviteteve të KKIE-së, ai është bërë publik çdo vit së bashku me raportin vjetor. Megjithatë, ky kalendar planifikimi është përbullur me vështirësi në fazën e zbatimit. Për shembull, në vitin 2017 apo 2018 janë mbajtur vetëm disa takime diskutimi (siç vërehet në tabelën 2). Mbetet për t'u analizuar më tej nëse ky mosperformim lidhet me mungesën e prioritizimit të aktiviteteve të KKIE-së nga Kryetari apo lidhet me mungesën e kapaciteteve organizative dhe mundësive të financimit. Në të dyja rastet, duhet të përfshihej një analizë përkatëse në raportin vjetor që KKIE i paraqet Parlamentit.

Duke u ndalur në **raportin vjetor** të KKIE-së të publikuar nga sekretariati teknik, ai nuk pasqyron saktësisht të gjitha zhvillimet që kanë ndikuar ose që lidhen me funksionimin e duhur të këtij mekanizmi konsultativ. Raporti nuk ndjek një strukturë të standardizuar, e cila mundëson një analizë të plotë të aktiviteteve vjetore të planifikuara, të sfidave të hasura dhe të mosrealizimit të tyre, së bashku me detaje të tjera praktike si struktura aktuale e sekretariatit teknik. Raporti jep vetëm një [përshkrim të përgjithshëm të arritjeve](#) të Këshillit Kombëtar të Integritit European, si p.sh. "[k]jo strukturë ka forcuar më tej rolin kontrollues të Kuvendit në procesin e integritit european, duke mundësuar fuqizimin e vazhdueshëm të rolit të tij, si një aktor i rëndësishëm në monitorimin e detyrimeve të anëtarësimit". Është ende e paqartë se si kjo është bërë e mundur, duke pasur parasysh që KKIE është

mbledhur vetëm një herë në shkurt të vitit 2017. Për më tepër, ekziston një mbulim joproportional i disa çështjeve (p.sh. gjatësia e përshkrimit të edicionit 2017 të shkollës verore është 4 faqe nga 11 në total) dhe përjashtim i disa çështjeve të tjera. Për shembull, raportet vjetore të vitit 2017 dhe 2018 nuk përmendin bojkotin parlamentar të opozitës dhe se si ka ndikuar kjo në respektimin e dispozitave në fuqi të KKIE-së.

**Tabela 2:** Programi vjetor i punës së KKIE-së, 2017-2018

	2017		2018	
	Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar
Takime periodike	4	1	4	2
Diskutime publike	1	3	0	1
Tryeza/Konferenca	3	0	3	0
Shkolla verore	1	1	1	1

*Burimi:* Faqja e internetit e Parlamentit; përpunim i autorit.

### BASHKËPUNIMI NDËR-PARLAMENTAR BE-SHQIPËRI

Bashkëpunimi ndër-parlamentar midis Parlamentit Evropian dhe Asamblesë së një vendi potencial për anëtarësim ka dëshmuar të jetë një mundësi e dobishme për ndarjen e përvojave midis anëtarëve të parlamenteve, si dhe për rritjen e pronësisë lokale mbi proceset reformuese. Në vitin 2010, u institucionalizua Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri, si një mekanizëm bashkëpunimi konsultativ i angazhuar në të gjitha aspektet e marrëdhënieve të ndërsjella, veçanërisht në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Bazuar në përvojën e kaluar, KPSA u deklarua më tej nga dispozitat e ligjit 15/2015 si një mekanizëm i përbashkët i Parlamentit shqiptar dhe Parlamentit Evropian, i cili synon të shërbejë si një nxitës i bashkëpunimit për përmirësimin e dialogut politik rreth agjendës evropiane të vendit.

Në përgjithësi, performanca e KKIE-së gjatë dy viteve të fundit nuk ka arritur të përmbushë objektivat e vendosura dhe aktivitetet e tij janë minuar nga agjendat e partive politike. Krahasuar me raportin e monitorimit të publikuar më parë ([tetor 2016](#)), KKIE ka hasur pengesa, dhe për shkak të klimës aktuale të pafavorshme, rrezikon të bëhet një mekanizëm konsultimi obsolet.

Në parim, Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asociimit organizon dy takime në vit, të cilat lejojnë një shkëmbim të ndërsjellë midis anëtarëve të parlamenteve mbi reformat e ndërmarra në nivel vendor, sfidat e hasura dhe hapat e planifikuar në vazhdim. Në rastin shqiptar, ky mekanizëm bashkëpunimi nuk ka arritur të veprojë siç pritet gjatë dy viteve të fundit. Zhvillimet politike nuk kanë lejuar nxitjen e bashkëpunimit të ndërsjellë me anëtarët e Parlamentit Evropian, megjithëse roli i tyre ka qenë thelbësor në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të brendshme politike në Shqipëri. Në veçanti, gjatë vitit 2017 nuk ishte e mundur të mbaheshin takime të KPSA-së për shkak të bojkotit të opozitës të aktiviteteve të Kuvendit gjatë pranverës (zgjidhur falë një marrëveshjeje të ndërmjetësuar ndërkombëtarisht) dhe për shkak të legjislaturës së sapoformuar të Parlamentit shqiptar në vjeshtën e po atij viti. Ndërsa, në vitin 2018 takimet e KPSA-së u mbajtën sipas procedurave të zakonshme (siç vërehet në tabelën 3).

**Tabela 3:** Kalendarri i takimeve të KPSA-së, 2017-2018

No.	Data	Vendi	Rekomandime
	2017	Nuk u mbajt asnjë takim	
XII	12-13/02/2018	Tiranë	<a href="#">Miratuar</a>
XIII	15/10/2018	Bruksel	<a href="#">Miratuar</a>

*Burimi:* Parlamenti Evropian

Përsa i përket *përmbajtjes*, analiza e procesverbalit, raportit të misionit dhe xhirimet e dy takimeve të vitit 2018, tregojnë se temat në diskutim kanë qenë rreth pesë makro-fushave, të cilat korrespondojnë edhe me pesë prioritetet kyçe që duhet të përmbushë Shqipëria në mënyrë që të hapen negociatat për anëtarësim. Fokusi është përqendruar veçanërisht në temat e mëposhtme: (i) gjendja aktuale e marrëdhënieve BE-Shqipëri; (ii) gjyqësori dhe çështjet e brendshme; (iii) dialogu politik në vend; (iv) reforma zgjedhore; dhe, (v) çështje të tjera si të drejtat themelore, liria e medias etj.

Të dy takimet kanë përfunduar me miratimin e rekomandimeve përfundimtare, të cilat kanë një natyrë jo detyruese dhe konsiderohen të rëndësishme në kuadër të frymës së bashkëpunimit dhe dialogut midis delegacioneve parlamentare pjesëmarrëse. Këto rekomandime ndjekin një strukturë të standardizuar, duke adresuar sfidat akute të Shqipërisë, duke theksuar pikat që kërkojnë vëmendje më të madhe dhe ndërhyrje, si dhe mirënjohje për arritjet drejt anëtarësimit në BE të Shqipërisë, veçanërisht në lidhje me procesin e vettingut. Duke u ndalur në veçanti tek roli dhe kontributi i Parlamentit shqiptar në procesin e integritetit evropian, këto rekomandime përsërisin fuqishëm nevojën për të krijuar një dialog politik konstruktiv dhe bashkëpunim të qëndrueshëm ndërpartiak, të shoqëruar nga angazhimi serioz i qeverisë dhe opozitës. Përfaqësuesit e Parlamentit Evropian kanë

dënuar vazhdimisht dominimin e përplasjeve politike dhe polarizimin e vazhdueshëm, si një pengesë kryesore për progresin e vendit në procesin e anëtarësimit.

Pavarësisht thirrjeve të përsëritura për dialog dhe "[konsensus ndërpartiak për agjendën e reformave kundrejt interesave afatshkurtra politike](#)", marrëdhëniet midis delegacionit shqiptar, si dhe ndërmjet partive politike në nivel vendor nuk kanë arritur të përmirësohen gjatë dy viteve të shkuara. Deri më tani, vërehet një retorikë e dukshme politike, mungesë gatishmërie për t'u ulur në tryezën e dialogut dhe për të demonstruar pjekuri dhe fleksibilitet mbi përparësitë kryesore kombëtare, siç është procesi i anëtarësimit në BE. Kjo klimë e brendshme dekonstruktive minon përpjekjet e integritetit në BE dhe kjo u pasqyrua edhe gjatë takimit me përfaqësuesit e BE-së. Ishte e dukshme edhe [gjatë takimit të fundit të KPSA-së në Bruksel](#), ku një përfaqësues i opozitës shqiptare pati një mosmarrëveshje verbale të pakëndshme me kryetaren e delegacionit të Parlamentit Evropian, ndjekur më pas nga vendimi i përfaqësuesve të opozitës të bojkotonin takimin.

Përballë këtij polarizimi të mprehtë, është e vështirë të parashikohet një zgjidhje e zbatueshme dhe rekomandime përkatëse që do të lejonin rivendosjen e dialogut. Në vitin 2019 KPSA-ja BE-Shqipëri nuk do të mbajë asnjë takim, pasi gjendja aktuale politike në vend nuk e mundëson diçka të tillë gjatë seancës së pranverës dhe për shkak të fillimit të legjislaturës së re të Parlamentit Evropian në vjeshtën e po të njëjtit vit.

### KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Roli i Parlamentit shqiptar, dhe veçanërisht i dy mekanizmave të tij konsultativ, nuk ka



arritur të ketë sukses në krijimin e një dialogu të qëndrueshëm politik mbi prioritetin kryesor të vendit, anëtarësimi në BE. Aktivitetet e këtyre dy mekanizmave vazhdimisht janë penguar nga retorika e ashpër politike, interesat e partive dhe mungesa e dukshme e gatishmërisë për dialog dhe bashkëpunim ndërpartiak. Përsëritja e bojkoteve të aktiviteteve të Parlamentit gjatë dy viteve të fundit dëmton seriozisht përpjekjet për reforma dhe ambiciet e qytetarëve për t'iu bashkuar Bashkimit Evropian në dekadën e ardhshme. Është e vështirë të parashikohet në këtë fazë drita e gjelbër nga ana e BE-së për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë, duke pasur parasysh kredibilitetin e ulët të partive politike.

Megjithatë, është e rëndësishme të vazhdohet me forcimin e institucioneve demokratike dhe mekanizmave përkatës, përmes një pjesëmarrjeje më të gjerë të aktorëve jo-politik. Përfshirja dhe kontributi i tyre i drejtpërdrejtë është thelbësor për një transparencë dhe llogaridhënie më të madhe dhe duhet të shërbejë si një masë kundërpeshuese për rreziqet e mundshme për hapa pas. Prandaj Këshilli Kombëtar i Integritetit Evropian duhet të vazhdojë të mbajë takimet periodike dhe të organizojë aktivitete të përbashkëta ndërorgjeshuese, nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë të të gjithë anëtarëve të përhershëm dhe jo të kufizuar vetëm në pjesëmarrjen e Kryetarit/Zëvendës Kryetarit të tij.

**Së pari**, KKIE duhet të vazhdojë me rishikimin dhe përmirësimin e bazës ligjore për përfshirjen e aktorëve të shoqërisë civile, pasuar nga përmbyllja e procesit të përzgjedhjes së OSHC-ve dhe përfaqësuesve të medias. Gjithashtu, duhet të mundësohen një sërë instrumentesh praktikë në mënyrë që të

mundësohet një bashkëpunim konkret me shoqërinë civile.

**Së dyti**, KKIE duhet të organizojë një proces konsultimi të brendshëm mbi format e mundshme të bashkëpunimit të cilat kontribuojnë pozitivisht në thyerjen e lidhjes së varësisë midis mosmarrëveshjeve politike dhe performancës së Këshillit. Një zgjidhje alternative do të ishte rritja e numrit të anëtarëve të përhershëm jo-politikë dhe bashkë-kryesimi i takimeve.

**Së treti**, KKIE duhet të bjerë dakord për miratimin e konkluzioneve, deklaratave dhe/ose të rekomandimeve në fund të çdo takimi periodik. Kjo do të mundësojë një orientim më të mirë të diskutimeve gjatë takimeve, do të kishte një kontribut më të lartë dhe do të ishte një levë e këtij mekanizmi përballë qeverisë dhe publikut të gjerë.

**Së katërti**, sekretariati teknik duhet të bëjë më shumë përpjekje në drejtim të standardizimit të instrumenteve raportues, planifikimin e aktiviteteve, si dhe transparencën më të lartë mbi punën e Këshillit. Për më tepër, promovimi i punës së KKIE-së dhe përpjekjet për advokim duhet të bëhet edhe nga sekretariati teknik përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në aktivitete publike, fushata informimi, dita e Evropës etj. Struktura e sekretariatit teknik duhet të bëhet publike, së bashku me buxhetin vjetor.

**Së pesti**, siç u theksua edhe në punimin monitorues të vitit 2016, KKIE duhet të sigurojë transparencë më të lartë dhe komunikim më të mirë me publikun. Seksioni i caktuar në faqen e internetit të Parlamentit nuk është i përshtatshëm për përdoruesin dhe është vështirë të gjendet. Informacioni i ofruar në faqen e internetit është i kufizuar vetëm me listën e anëtarëve, bazën ligjore dhe procesverbalet e takimeve - duke përjashtuar materialet e ofruara nga folësit

e ftuar gjatë takimeve. Për shkak të mospërputhjeve në procesverbalet e publikuara, është e vështirë të përcaktohet se sa herë që një anëtar ka marrë pjesë në mbledhje.

**Së gjashti**, KKIE duhet të publikojë në internet një regjistër të kërkesave për informacion/përditësimeve që i dërgon institucioneve të ndryshme shtetërore që merren me procesin e integritimit në BE. Ky regjistër do të lejonte gjurmimin dhe

monitorimin e aktivitetit të KKIE-së mbi çështjet e BE-së, si dhe përgjegjshmërinë e institucioneve publike përkatëse.

**Së shtati**, rregullorja duhet të përfshijë masa specifike për anëtarët që nuk marrin pjesë në mbledhje për një periudhë të caktuar kohore. Për më tepër, duhet të parashikohen incentiva për pjesëmarrjen dhe kontributin cilësor të anëtarëve gjatë këtyre takimeve.

**EU  
POLICY**



*Briefs*

# HUB MONITOR

HUB Monitor përbën një nga katër shtyllat e aktiviteteve të Forumit të Politikave të Integritimit me synim monitorimin nga afër të procesit të integritimit në BE dhe të institucioneve të përfshira në të.

Hub Monitor publikohet në mënyrë periodike që prej vitit 2016 dhe punimet e tij fokusohen në dy linja prioritare: (i) Monitorimin e institucioneve përgjegjëse për Integritimin Evropian, si dhe dokumentet ligjorë dhe raportet e publikuar nga institucionet përkatëse; (ii) Trajtimin e thelluar të politikave dhe përafrimi i legjislacionit kombëtar me acquis e BE-së.

Dokumentet e Politikave – Policy Brief, të Hub Monitor hartohen nga anëtarët e forumit në bashkëpunim me ekspertë të fushës.

Më poshtë gjeni listën e publikimeve të fundit të Hub Monitor:

[Zona Ekonomike Rajonale: Nga Konceptualizimi tek Zbatimi, Baisa Sefa](#)

[Themelimi i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile: Sfidë apo Arritje?, Gentiola Madh](#)